

REFORMA DHE EDUKIMI QYTETAR NË UNIVERSITETE

Silvana VISHKURTI

Qendra e Gjuhëve të Huaja, Universiteti Politeknik i Tiranës

SHQIPERI

PËRMBLEDHJE

Ky punim synon të verë në dukje rolin që shkolla e lartë në Shqipëri duhet të luajë në edukimin qytetar të të rinjve me ndjenjën e përgjegjësisë dhe të veprimit shoqëror. Pasi shpjegon modelin edukues që ka mbizotëruar në shoqërinë shqiptare dhe vështirësitë për ta ndryshuar atë pas viteve '90, studimi përqendrohet në analizën e një pyetsori të plotësuar nga 56 studentë që kryejnë studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe në Universitetin e Tiranës si dhe në disa përfundime të nxjerra nga përvoja e mësimdhënies së lëndës "Kulturë Evropiane". Hipoteza që duam të vërtetojmë është se vetëm nëpërmjet një edukimi ndryshe shkolla mund t'u përgjigjet zhvillimeve të sotme dhe të ardhme të shoqërisë. Pa pretenduar të jetë shterues punimi hulumton për një të mësuar aktiv e bashkëpunues ndaj dijes si dhe larmisë së këndvështrimeve që mund t'u edukohen të rinjve për ti shdërruar ata në qytetarë të angazhuar.

Fjalët kyçe: Reformë, politika edukimi, gjykim kritik, qëndrim bashkëpunues, hapësirë edukuese.

ABSTRACT

This paper aims at highlighting the role that

higher education in Albania should play in the civic education of the youth with the sense of social responsibility and action. After having explained the education model which prevailed in the Albanian society and the difficulties to change it after the '90-s, the study focuses on the analysis of a questionnaire filled in by 56 students of the Polytechnic University of Tirana and University of Tirana and some conclusions drawn as a result of the experience of teaching the "European Culture" course. The hypothesis we would like to confirm is that school could respond to the current and future changes of the society only through an education differently. Not claiming to be exhaustive, the paper researches on active and collaborative knowledge learning and range of viewpoints that can be taught to young people to transform them into involved citizens.

HYRJE

Ndryshimet e kryera në fushën e arsimit në vendet e Bashkimit Evropian kanë nxjerrë në plan të parë përsosjen e sistemit arsimor për t'u përgjigjur sa më mirë nevojave të zhvillimit shoqëror si dhe përafrimin me njëri-tjetrin për vënien në zbatim të përvojave më të mira që qarkullojnë në tërë hapësirën evropiane.

Edhe universitetet shqiptare janë përfshirë në këtë proces dhe kanë shënuar arritje të dukshme në fushën e kurrikulave, në masivizimin e shkollës së lartë dhe në angazhimin profesional e qytetar të personelit akademik.

I konceptuar si një *shërbim shoqëror* sistemi arsimor duhet të krijojë mundësitë për të zhvilluar individualitetin dhe aftësitë e gjithësecilit për tu integruar sa më natyrshëm në shoqëri. Si i tillë ai duhet jo vetëm t'i formojë profesionalisht, por edhe t'i edukojë të rinjtë se si të zhvillojnë anën shpirtërore të jetës në marrëdhëniet me tjetrin me qëllim që ata të formohen edhe si *qytetarë aktivë*. Ndërvartësia e këtyre funksioneve është jetike për vetë sistemin sepse, siç shprehet Condorcet: "Qytetari nuk është i lirë nëse nuk është i arsimuar" (1). Sa ka arritur shkolla në Shqipëri veçanërisht universiteti ta realizojë një mision të tillë? Nëse ndryshimi i programeve e ka reformuar përmbajtjen e dijes duke e lidhur atë me shumë me nevojat e shoqërisë, shumë pak është bërë në drejtim të edukimit qytetar si pasuri e marrëdhënieve ndërindividuale dhe zhvillim personal. Premisa nga e cila nisemi është se edukimi qytetar nuk mund të kufizohet vetëm në përfshirjen në kurrikula të disa lëndëve shoqërore. Ai realizohet duke edukuar aftësi e qëndrime të reja në mënyrën e marrjes së dijes në tërësi. Kjo do të thotë se mësimi nuk mund të zhvillohet më sipas parimit të përvetësimit pasiv të nocioneve, por në funksion të nevojës për të mësuar si të mësosh në mënyrë të përgjithshme dhe konkrete.

Për këtë qëllim ky punim është bazuar jo vetëm në shqyrtimin e gjendjes së edukimit qytetar në universitete, por edhe në përfshirjen e këtij të fundit në mësimdhënien e lëndës "Kulturë Evropiane". Përvoja e përfutur tregon se ndryshimi i pedagogjisë së mësimdhënies çon në një përvetësim aktiv e të qëndrueshëm të dijes si dhe në një zhvillim të gjithanshëm të personalitetit të rinjve duke i përgatitur ata që në shkollë për sfiat që i presin në jetën shoqërore.

1. ANALIZA DHE VËZHGIME

Për të hetuar gjendjen e edukimit qytetar në universitete studimi është bazuar në interpre-

timin e një pyetsori rezultatet e të cilit janë testuar në mësimdhënien e lëndës "Kulturë Evropiane" me qëllim që propozimet të jenë sa më konkrete.

1.1. Analiza e pyetsorit

56 studentë që ndiqnin studimet në vitin e tretë në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe në vitin e dytë në Universitetin e Tiranës morën pjesë në plotësimin e pyetsorit. Ky i fundit u ndërta me 14 pyetje gjysëm të hapura dhe përbëhej nga dy pjesë. Në të parën kërkohej mendimi i studentëve mbi anë të edukimit si konceptimi i marrëdhënieve me të tjerët, raporti midis edukimit profesional dhe atij të përgjithshëm, midis së drejtës dhe detyrës si dhe roli i vlerave në shoqërinë shqiptare. Në të dytën, u kërkuar të jepnin mendimin mbi procesin e mësimdhënies, mbi marrëdhëniet pedagog-student, mbi mënyrën e përvetësimit të dijes, raportin teori/praktikë, rolin e punës në grup dhe pritshmërinë ndaj shkollës. Jemi të ndërgjegjshëm se ky pyetsor mbart edhe kufizime për faktin se në mjaft raste studentët janë përgjigjur duke pasur parasysh se *si duhet të jenë gjërat dhe jo se si janë* në të vërtetë.

Studenti tipik që ne zgjodhëm i përket ciklit të parë të studimeve, ka zhvilluar lëndë shoqërore dhe ka një përvojë universitare (viti II/III).

Në interpretimin e të dhënave është mbajtur parasysh denduria tematike e të dhënave. Pyetjes nëse *lëndët shoqërore janë të domosdoshme* për formimin e tyre ata i janë përgjigjur pozitivisht. Vetëm 3 prej tyre mendojnë se lëndë të tilla janë larg profilit të tyre inxhinierik dhe se nuk kanë lidhje me degën që studjojnë.

Në *besimin* e tyre ndaj vlerave të shoqërisë ku jetojnë, ata shprehen të shqetësuar për faktin se jetojnë në një mjedis ku ka një dyzim vlerash, se po shkojnë "drejt një hipokrizie masive ku mbizotëron gënjeshtria, injoranca e agresiviteti".

Në *marrëdhëniet pedagog-student* ata theksojnë se përgjegjësia është e dyanshme. Nga njëra anë, pedagogët duhet të jenë më kërkues, më bashkëpunues dhe duhet t'i nxisin studentët të shprehen lirshëm në klasë. "Më pak ofendime e më shumë respekt për studentin" shprehet njëri prej tyre.

Përsa i përket mësimdhënies ata shprehen se

mësimi është shumë abstrakt, se lëndët shihen më tepër në aspektin teorik sesa në atë praktik.

Ata e vlerësojnë punën në grupe: "është eksploruese, njeh aftësitë e tua duke u krahasuar me të tjerët, mëson të ndash detyrat e të bësh lëshime reciproke" – shprehet njëra nga anketueset. Në fakt, ajo përdoret fare pak në procesin mësimor.

Një drejtim tjetër ku ata ndjejnë se mund të marrin pjesë janë *veprimtaritë shkollore e jashtëshkollore*. Ata ndjehen të mënjanuar nga çdo akt vendimmarrjeje në universitet dhe do të pëlqenin më shumë *shkëmbime kulturore* brenda dhe jashtë vendit. Njëra prej tyre madje dëshiron të jetë pjesëtare e Unicef-it për të ndihmuar njerëzit në nevojë.

1.2. Vëzhgime në klasë

Nisur nga ideja se ndryshimi duhet filluar nga vetja u përpoqëm që vërejtjet e studentëve t'i reflektonim në mësimdhënien e lëndës "Kulturë evropiane". Organizimi i saj u bazua në një *kunikim ndërroepues* ku u kombinua përvoja e studentëve me shpjegimin e pedagogut. Kryerja e një pune kërkimore në grup si dhe përfshirja e studentëve në vlerësim ishin elementë të rinj që u shtuan programit.

Puna në grup synonte bashkëpunimin e studentëve për arritjen e objektivave të përbashkëta. Nga njëzet tema mbi edukimin qytetar më të parapëlqyerat ishin: "Edukimi fetar", "Zgjidhja e konflikteve" dhe "Qytetaria evropiane". Figura e mëposhtme pasqyron shkallën e përzgjedhjes së tematikës së propozuar:




Figura 1. Përzgjedhja e temave në përqindje

Edukimi fetar është parë në prizmin e vlerave që ne përçojmë si komb, por edhe si shqetësim i nisjes së konflikteve në botë. Zgjidhja e konflikteve i ka tërhequr për faktin se *intoleranca* vazh-

don të jetë faktor mbizotërues i jetës shqiptare. "Përshtatja me mendimin ndryshe është shumë e vështirë – shprehen ata duke vazhduar se – njohja me konfliktet do të na japë një ide mbi pasojat që ato sjellin". Ndërsa qytetaria evropiane shihet më tepër si një ideal zhvillimi e integrimi. Janë ngërthyer kështu në mënyrë të natyrshme një vlerë, një problem dhe një ideal.

Për sa i përket vlerësimit u ndoq *metoda e pjesëmarrjes* se studentëve në vendimmarrje. Kështu u vendos me marrëveshje që detyra e kursit të zinte vetëm 10% të vlerësimit përfundimtar.

Konceptimi ndryshe i orës së mësimi i dha asaj më shumë dinamizëm, zgjoi një debat të fortë mes studentëve, por i bëri më të kujdesshëm në zgjedhjen e fjalës dhe argumentit. Nga ana tjetër, u vunë re etiketime të studentëve që merrnin pjesë gjallërisht në debat, një reagim përcmues i fortë ndaj vajzave kur mbronin rolin e tyre në klasë apo dhe një qëndrim tallës ndaj mendimit ndryshe të tjetrit.

Duhet theksuar se mësimdhënie të tilla jo gjithmonë rezultojnë pozitive, por ato janë frytdhënëse për të dyja palët sepse janë në kërkim të metodave të reja për përvetësimin e dijes dhe gjetjes së një mirëkuptimi reciprok. Për këtë arsye ato duhet të nxiten për të krijuar një klimë më bashkëpunuese në klasë duke thyer stereotipin se studenti nuk di asgjë dhe duhet ta ulë kokën e të mësojë dhe se pedagogu di gjithçka dhe ka gjithmonë të drejtë.

2. INTERPRETIME DHE PËRFUNDIME

Për të analizuar në mënyrë sa më të plotë dukurinë e edukimit qytetar është parapëlqyer një ndërthurje e analizës historike me atë bashkëkohore.

Zhvillimi historik i sistemit arsimor në Shqipëri përshkohet nga përpjekjet për *mësimin e gjuhës shqipe* dhe *përhapjen e dijes*. Por dihet se *edukimi me kulturat e huaja* ka qenë tipari kryesor i formimit të intelektualëve shqiptarë pavarësisht se dijet e tyre i kanë vënë në shërbim të *ruajtjes dhe përhapjes së kulturës kombëtare* (3).

Mbas Luftës së dytë botërore një nga meritat e arsimit shqiptar është *ulja e shkallës së analfabe-*

tizmit. Në vitet '50 të ndikuar nga modeli sovjetik kemi një sistem të plotë arsimor të ndarë në stade. Veçori e edukimit në arsimin e lartë të kësaj periudhe, krahas anëve pozitive si përhapja e dijes shkencore dhe njesimi i gjuhës letrare shqipe, mbetet ideologjizimi dhe hermetizimi i dijes dhe edukimit.

Me zhvillimet demokratike që ndodhën pas viteve '90 arsimit i lartë filloi të rimëkëmbet. Një nga elementet qytetare të kësaj periudhe janë binjakëzimet e shkollave shqiptare me ato të vendeve të tjera (4).

Si rrjedhojë e përfshirjes së sistemit të arsimit shqiptar në "Zonën evropiane të arsimit të lartë" dhe firmosjen e dokumentit për zbatimin e procesit të Bolonjës, mjaft lëndë shoqërore filluan të përfshihen në programet e shkollave të larta. Por problemet e edukimit u trajtuan kryesisht në fushën e edukimit nëpërmjet njohjes dhe jo edukimit tërësor të studentit. Ndaj dhe edukimi me një qytetari demokratike duhet të synojë krijimin e kushteve të domosdoshme për krijimin e një hapësire të vërtetë edukuese në shkollat e larta.

Kjo arrihet në rradhë të parë nëpërmjet një edukimi me frymën kombëtare, me një qëndrim realist ndaj vlerave dhe traditës. Që në vitin 1915, në Sofje, Mid'hat Frashëri shkruante se "e ardhmja e një kombi varet mbi dy gjëra: mbi vlerën morale dhe mbi numrin e tij" dhe më tej vazhdon: "Mosdija e historisë sonë, harrimi në të cilat gjendemi për gjyshërit dhe stëgjyshërit tanë, moskujdesja e arsimit kombëtar, gjithë këto na kanë bërë që të mos njohim veten" (5).

Nga ana tjetër, krijimi i një sistemi të qëndrueshëm rregullash morale që fillon e zbatohet që në shkollë nuk mund të kuptohet pa veprimin e fuqisë shtrënguese ndaj atyre që i shkelin ato. Duke kaluar nga një shoqëri e mbyllur, ku kjo fuqi ishte mbizotëruese, shoqëria e sotme shqiptare ndjen alergji ndaj kësaj dukurie dhe ende nuk arrin të dallojë qartë fuqinë dënuuese të ligjshme nga ajo e paligjshmja. (6) Shkolla është një nga vatrat ku duhet të bëhet një edukim i tillë.

Edukimi me një shoqëri demokratike nuk mund të kuptohet pa një konceptim të ri të ma-

rrrëdhënieve pedagog-student. Kjo do të thotë një lidhje më e natyrshme e marrëdhënies autoritare me atë bashkëpunuese e dialoguese. Për këtë pedagogu duhet të formohet jo vetëm nga ana profesionale, por edhe pedagogjike. Ai duhet të praktikojë forma të reja që ngjallin dashurinë për dijen e të vërtetën, duke e parë studentin si "aktor - zotërues i dijes" (7) dhe jo thjesht si një marrës njohurish. Një student që nuk sheh dobinë e asaj që mëson, që nuk e merr me kënaqësi atë çfarë bën nuk mund të jetë një element dinamik në shoqëri, pasi nuk mund të ketë jetë intelektuale pa pasion dhe përkushtim ndaj asaj që kryen.

Një dukuri tjetër është dhe mënyra se si konceptohet zënia e kohës së lirë. Kjo e fundit po orientohet kryesisht drejt anës zbavitëse (kafe, lojra fati, internet) ndaj kërkohet një organizim më i madh veprimtarish shkollorë dhe jashtëshkollorë për t'i tërhequr studentët në veprimtari ku të edukohet ndjenja e së bukurës, e së dobishmes dhe e zhvillimit të plotë të personalitetit në marrëdhënie me të tjerët.

Një shoqëri që ndryshon në mënyrë të vrullshme ku vëllimi i njohjes është i pamatë, sfidohet vetëm duke mësuar si duhet mësuar me qëllim që edukata shkollorë e punës të vlejë për të mësuarit gjatë gjithë jetës, ndaj mënyrat e të mësuarit duhet të nxisin larminë e këndvështrimeve që t'i aftësojnë studentët për t'i studjuar dukuritë në mënyrë të shumanshme e kritike me qëllim përmirësimin e tyre.

3. PERSPEKTIVA

Veçori e edukimit me një qytetari demokratike në Shqipëri është krijimi i bazave njohëse e formuese të këtij lloji edukimi.

Për këtë kërkohet që përgatitja profesionale e pedagogëve të mos kufizohet vetëm në përditësimin e dijes, por dhe në gjetjen e atyre praktikave pedagogjike që nxisin dhe lehtësojnë marrjen e dijes si dhe rrisin aftësinë e zbatimit praktik të saj.

Ky ndryshim nuk mund të realizohet pa një konceptim më të gjërë të vendit që duhet të zejë kultura e përgjithshme në jetën profesionale si pjesë

e formimit të gjithanshëm të individit.

Në këtë drejtim, duhet të punohet ende në drejtim të zbatimit në praktikë të një pedagogjie aktive ku të vlerësohet *studenti*, nevojat dhe përvoja e tij jetësore.

Si përfundim mund të themi se përfshirja e edukimit qytetar në universitete është një domosdoshmëri jetike për një shoqëri demokratike.

Universitet shqiptare, për të kryer sa më mirë funksionin e tyre qytetërues, duhet të shndërrohen në një *pol të fuqishëm* të mendimit më të përparuar shoqëror duke i shndërruar hapësirat universitare në vende ku debatohet dhe praktikohet zgjidhja e problemeve.

BIBLIOGRAFIA

1. Verdelhan-Bourgade (2001), *Ecole, langage et citoyenneté*, punim kolektiv, l'Harmattan, përmbledhje.
2. Kabo P. (Tiranë, 2006), *Autoritarizëm në tranzicion*, Plejad, f. 347.
3. Sauku-Bruçi M. (Tiranë, 2004), *Elena Ghika a Girolamo di Rada-Lettere di una principessa*, Bargjini, f.20-25.
4. Leka F. (Tiranë, 2007), *Shkrime gjuhësore, letrare, sociale*, Infbotues, f. 468.
5. Butka, U. (1997), *Kthimi i Mid'hat Frashërit*, Phoenix, f. 47.
6. Devole R. (1998), *Albania-fenomeni social e rapresentazioni*, Agrilavoro, f. 81.
7. Pastiaux G. et J. (1996), *Précis de pédagogie*, Nathan, f. 26.